**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA GRAMSH**
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr__________Prot. Gramsh më 25 /09 / 2023

Shtojca 13

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Datë 25.09.2023

Drejtuar: OE "SHENDELLI " SHPK , me adresë : Lagjia "Kastrioti" Rruga "Andon Profka " , 2 kullat ,Fier.
Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-77193-8-10-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion i zyrave të Këshillit Bashkiak dhe zyrave të katit të parë të Bashkisë Gramsh"

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike : Buletini Nr. 69 datë 14.08.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto □

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **x**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE " CARA" sh.p.k NIPT K07729920F

Vlera *3, 498,480 (tre milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë ) lekë, pa TVSH.*

2. BOE "2 Z KONSTRUKSION "sh.p.k & "ASI-2A CO" sh.p.k NIPT J63229466K & K53002402C

Vlera *4,468,750 (katër milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë)lekë, pa TVSH.*

3. OE " SHENDELLI" sh.p.k NIPT K07924803N

Vlera *4, 491, 191 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një ) lekë, pa TVSH.*

4. OE "INERTI" sh.p.k NIPT J66926804L

Vlera *4, 994, 718 (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, pa TVSH.*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. <u>BOE "2 Z KONSTRUKSION "sh.p.k & "ASI-2A CO" sh.p.k J63229466K & K53002402C</u>

Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave konstatohet se ky BOE nuk përmbush të gjithë kriteret lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te Kualifikimit te pershkruara ne DST konkretisht:

- Ofertuesi ka dorëzuar ofertën e tij si bashkim i operatorëve ekonomikë "2Z KONSTRUKSION" sh.p.k & "ASI-2A CO" shpk, nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit datë 19.08.2023 ku deklarojnë se kane rene dakord midis tyre per ndarjen e perqindjes se pjesemarrjes per realizimin e objektit te procedures tenderuese konform kerkesave te termave te references dhe legjislacionit per objekte te tilla.

  Ndarja e perqindjeve eshte si me poshte:

  Shoqëria "2Z KONSTRUKSION" sh.p.k, 59.94% te pjesëmarrjes dhe fitimit

  Shoqëria "ASI-2A CO" sh.p.k , 40.06% te pjesëmarrjes dhe fitimit

Ndërkohë referuar preventivit të ndarjes së punimeve Shoqëria "2Z KONSTRUKSION" sh.p.k merr përsipër 91.9% të punimeve ndërsa shoqëria "ASI-2A CO" sh.p.k merr përsipër 8.1% të punimeve, në kundërshtim me cfarë palët kanë deklaruar se kanë rënë dakord si më sipër.

- Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:**

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
   1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:
   2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
   3. Situacionin përfundimtar të objektit;
   4. Aktin e kolaudimit;

5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;
6. Faturat tatimore te prera per objektin;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve, shoqëruar me:
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Fatura tatimore perfundimtare.

Anëtari i BOE "2Z KONSTRUKSION" sh.p.k, për plotësimin e kriterit të mësipërm ka dorëzuar dokumentacion lidhur me kontratën nr.7860 prot datë 22.11.2021 me Objekt "Rikonstruksion i kopshtit nr.1 në bashkinë Roskovec" i cili është i paplotë e në kundërshtim me dokumentat e kërkuara , konkretisht:

Formulari i vlerësimit nuk është plotësuar në të gjithë elementët e tij, pasi mungon data e fillimit dhe e mbarimit të punimeve.

Mungojnë faturat tatimore të shitjes

Mungon akti i marrjes në dorëzim të punimeve

- Anëtari i BOE "2Z KONSTRUKSION" sh.p.k, ka deklaruar 1 ing.hidroteknik në stafin e tij inxhinerik, përkatësisht Th.G. i cili nuk figuron në listë pagesat e shoqërisë maj-qershor , në kundërshtim me pikën 2.3.4 të kritereve të vecanta të kualifikimit , ku kërkohet 3 muaj e fundit nga data e zhvillimit të procedurës.
- Anëtari i BOE "2Z KONSTRUKSION" sh.p.k ka deklaruar një mjek të përgjithshëm P.T e cila nuk figuron në listë pagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit si dhe i ka përfunduar kontrata e punës më datë 15.03.2023.
- Me shkresë ne.3287 datë 29.08.2023 të KVO-së i është kërkuar Bashkisë Roskovec kërkesë për vënie në dispozicion të dokumeëntacionitb , konkretisht shtojcën 8 "Formularin Përmbledhës të vetëdekalrimi " per dy procedura prokurimi ku është shpallur fitue "OE" 2Z Konstruksion" shpk, konkretisht procedurat me objekt " Riparim i pjesshëm i shkollave nën administrimin e bashkisë Roskovec ", dhe "Rikonstruksion i shkollës "Naum Doko, ambienteve sportive dhe atyre të jashtme".
  Nga indormacioni i dërguar në rrugë elektronike nga Bashkia Roskovec, formularët përmbledhës të vetëdekklarimit për të dy objektet e cituar më sipër konstatohet se:
  Mjetet e deklaruara në procedurën objekt vlerësimi janë deklaruar edhe në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i shkollës "Naum Doko, ambienteve sportive dhe atyre të jashtme" konkretisht mjetet Kamion vetështkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, me targa AA525DJ,AA015ZX, AA953BF, Kamion me vinc AA594CY,

AA672IV,Autobot uji AA217JY.Kështu që ky OE nuk përmbush kriterin për dy Kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton.
Gjithashtu stafi i deklaruar në procedurën objekt vlerësimi është deklaruar njëkohësisht edhe në dy procedurat e zhvilluara nga AK Bashkia Roskovec,konkretisht ;Ing.ndërtimit,K.D,Ing.hidroteknik Th.G, teknik ndërtimi RR.T,bojaxhi L.C, pllakashtrues F.Z,E.Z, si dhe të dhjetë punëtorët të deklaruara dhe në dy procedurat e bashkisë Roskovec.
Ndërkoqë që ky OE ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit shtojca 8, të dorëzuar pranë AK bashkia Gramsh se i gjithë stafi i deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk është i angazhuar në asnjë kontratë dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti prokurimi.
Sa më sipër në bazë të përqindjes së marrë përsipër ky OE nuk disponon stafin teknik dhe stafin mbështetës të nevojshëm për realizimin e këtij objekti prokurimi.

2. Operatori ekonomik”Cara” sh.p.k me NIPT K07729920F

Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave konstatohet se ky OE nuk përmbush të gjithë kriteret lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te Kualifikimit te pershkruara ne DST konkretisht:

- OE “Cara” shpk nuk ka deklaruar në shtojcën 8, zj.M.Cara, nuk eshte i denuar ose nuk ka qene i denuar nga nje vendimi i gjykates i formes se prere per çdo veper penale, te percaktuar ne nenin 76/1 te LPP-se, e cila sipas ekstraktit të regjistrimit dhe prokurës së përgjithshme datë 04.07.2015, ka kompetenca perfaqesuese brenda Operatorit Ekonomik.
- Referuar vërtetimit të dorëzuar në SPE, OSHEE-2023-6093794-VM , datë 17.07.2023 , rezulton se OE “Cara” shpk , nuk ka likujduar detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajin qershor 2023 , detyrime të cilat kanë patur si datë perfundimtare të likujdimit datën 31.07.2023 , përprara datës së hapjes së ofertave.
- Nga verifikimi I dokumentacionit të dorëzuar në SPE për një autobot uji, konstatohet se mjeti I marrë me qira nëpërmjet kontratës nr.765 rep, 320 kol datë 25.09.2019 , bën fjalë për mjet për transportin e lëndëve të rrezikshme dhe jo për autobot uji, konkretisht “ certifikata e konformitetit e cisternës automobilistike e mallrave të rrezikshme nr.serial 000424, datë 01.09.2022, certifikata për transport ndërkombëtar mallrash të rrezikshme nr. 0000020139 datë 23.09.2022, si dhe certifikata e miratimit për mjetet që transportojnë mallrat të rrezikshme datë 22.09.2022. kështu që OE “Cara” shpk nuk përmbush kriterin për 1 autobot uji i parashikuar në pikën 2.3.7 të kritereve të vecanta të kualifikimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE "SHENDELLI “ SHPK , me adresë : Lagjia "Kastrioti" Rruga "Andon Profka " , 2 kullat, Fier, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej *4, 491, 191 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një )* lekë, pa TVSH / totali i pikëve të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[Bashkia Gramsh,Sheshi kamber Dermyshi, BLV 10 Korriku, kati i tretë i godinës, Personi Përgjegjës për Prokurimet]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO □ JO **X**

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)___________________

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO □ JO **X**

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)___________________

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**
**KRYETARI I BASHKISË**
**BESION AJAZI**